

Shkodër, konsultime për edukimin ligjor dhe arsimin juridik

Kryetari i Prezencës së OSBE-së, ambasadori Florian Raunig, i pranishëm në diskutimin mes anëtarëve të Komisionit të Posaçëm të Reformës në Drejtësi, Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe studentëve, pedagogëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile në qytetin e Shkodrës, theksoi rëndësinë themelore që ka krijimi i kulturës së shtetit të së drejtës. Ai shprehu kënaqësinë e përfshirjes në një dialog kombëtar mbi reformën në drejtësi, ku njeri prej komponentëve është dhe arsimit ligjor.

Anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Reformën në Drejtësi dhe Grupi Ekspertëve të Nivelit të Lartë, të cilët kanë punuar në hartimin e dokumentit “Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri – 2015”, ditën e martë, më 16 qershor 2015, ishin prezentë në një seancë konsultimi publik në mjediset e Universitetit “Luigj Gurakuqi” në qytetin e Shkodrës. Në auditor ishin studentë dhe pedagogë nga degët e fakultetit Juridik të këtij universiteti, si dhe përfaqësues nga organizatat lokale joqeveritare dhe media. Fillimisht të pranishmit u njohën me disa nga aspektet kryesore të Dokumentit Analitik të Reformës në Drejtësi, fokusuar më shumë në kapitullin ku jepet një pasqyrë e hollësishme e problematikës, dinamikës dhe infrastrukturës së edukimit ligjor dhe arsimit juridik në Shqipëri.

Si pjesmarrës në këtë diskutim të hapur, kryetari i Prezencës së OSBE-së, ambasadori Florian Raunig, theksoi në ndërhyrjen e tij se “pronarët” e kësaj reforme janë shqiptarët: institucionet demokratike të vendit dhe qytetarët. Sipas ambasadorit Raunig, “përprojekjet për të zhvilluar sistemin e drejtësisë të së ardhmes, duhet të kenë autorësi vërtet kombëtare, duhet të kenë autorësinë e secilit prej jush. Ja përse jam kaq i gëzuar që gjendem sot me ju, ndërsa përfshihemi në një dialog kombëtar për reformën në drejtësi, duke u përqendruar tek arsimit ligjor. Sepse arsimit ligjor nuk është vetëm për avokatët. Ju, si edukues profesionistë, jeni në krye të edukimit në të gjithë vendin me kulturën e shtetit të së drejtës. Ne, në OSBE, themi ‘shteti i së drejtës fillon nga ti’, që thekson rëndësinë themelore që ka krijimi i kulturës së shtetit të së drejtës. Sot, unë do të shtoja: ‘Reforma ligjore fillon dhe mbaron me ju’”-deklaroi mes të tjerave kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Pjesmarrësit në konsultim bënë vlerësime dhe komente mbi situatën në procesin e edukimit ligjor dhe arsimit juridik në Shqipëri, për nevojën e reflektimit dhe të përmirësimit në çdo hallkë të sistemit, që ndikon drejtëpërdrejtë në mbarëvajtjen e të gjithë sistemit të drejtësisë. Rishikimi dhe përshtatja cilësore e kurrikulave në sistemin arsimor parauniversitar, si dhe nevoja për një reformë në arsimin juridik,

duhet të garantojnë dhe respektojnë parimin e rëndësishme të autonomisë universitare dhe të lirisë akademike.

Anëtarja e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë, prof. dr. Aurela Anastasi, theksoi se në qendër të reformës nuk janë vetëm arsimit i lartë juridik dhe Shkolla e Magjistraturës, “por janë dhe arsimimi juridik në profesionet e lira, edukimi vazhdues dhe kualifikimi i punonjësve që shërbejnë në institucionet ndihmëse të drejtësisë, diskutimi juridik në arsimin parauniversitar, si dhe çështja e strategjisë për edukimin ligjor të publikut në tërësi. Këtu mendojmë se jemi thelluar, por natyrisht nga diskutimet që do të zhvillojmë sëbashku ne kemi nevojë të thellohem më shumë”.

Nisur nga parimi i gjithëpërfshirjes në procesin e Reformës në Drejtësi, organizatorët e konsultimit ftuan pjesmarrësit që të adresojnë mendime, sugjerime dhe propozime konkrete pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Drejtësi dhe Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë, përmes komunikimeve të drejtëpërdrejta ose virtuale, në hapësirën interaktive të website-t të Reformës: www.reformanedrejttesi.al. Konsultime mbi kapituj të veçantë të dokumentit “Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri – 2015” do të zhvillohen në vijim dhe në Korçë, Vlorë, Durrës e Pogradec dhe në Tiranë.